



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE**

### **EKSTRAKT**

**nga procesverbali i mbajtur më 15 tetor 2010, në mbledhjen e gjashtë të Komitetit për Komunitete.**

Mbledhja u mbajt në zyrën nr. 35 dhe filloi në orën 11.00.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti z. Burhan Blekçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj, z. Jahë Lahu, ndërkaq munguan z. Radisav Peroviq dhe z. Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Kap. Hilmi Mehmeti, Komanda Rajonale Kufitare Veriu – Lluzhan, z. Fadil Babatinca, Stacioni i policisë në Podujevë - Njësi për komunitete, z. Mefail Mustafa, OSBE – Zyra regjionale Ekipi për komunitete, z. Adam Walenzik, OSBE, z. Kunistah, LMT – KFOR dhe z. Ermira Hatipi, KAAD, partnere implementuese UNHCR.

#### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

#### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 6 shtator 2010**

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

#### **3. Aktivitetet e deritashme në funksion të realizimit të përgjegjësive të Komitetit për Komunitete dhe Planit të punës për vitin 2010**

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, e paraqiti fjalën e hyrjes i cili përveç tjerash theksoi se Komiteti për Komunitete ka mbajtur mbledhje të rregullta dhe në vijimësi është përpjekur në përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësive si dhe realizimin e Planit të punës për vitin 2010.

Janë siguruar 45 kopete të librave shkollor për shkolla të mesme, kopete të cilat kryesisht i janë ndarë nxënësve të komunitetit ashkalinj por një pjesë i janë ndarë edhe nxënësve të komunitetit shumicë të cilët e kanë pasur gjendjen e rëndë sociale.

Në vazhdim foli për vizitën e bërë në lagjen e sekiraqëve në fshatin Metergojc dhe trajnimet e mbajtura të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

Gjithashtu njoftoi se Plani i punës në aspektin e vizitave të planifikuara nuk është realizuar për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Në fund theksoi se dy kërkesat e shqyrtuara në një prej mbledhjeve të këtij Komiteti, Drejtoritë përkatëse të Administratës së Komunës ende nuk e kanë dhënë përgjigjen e kërkuar.

**z. Arbresha Hetemaj**, nënvizoi, e përmendi parafolësi se nuk janë realizuar vizitat e planifikuara për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe shtoi do duhej të bëhen të gjitha përpjekjet që të gjenden mjetet e nevojshme financiare dhe të bëhen vizitat ashtu siç është planifikuar në komunat Pejë, Prizren dhe Ferizaj.

**z. Nebih Behluli**, theksoi, takimi i mbajtur kohë më parë në Zyrën rajonale të OSBE-së në Prishtinë ka qenë i suksesshëm meqë janë këmbyer përvojat për punët dhe aktivitetet e Komitetit për Komunitete të komunave tjera, mirëpo gjithashtu u vërejt se në shumë komuna Komitetet për Komunitete punojnë pa Plane të punës, ndërkaq në Komunën e Podujevës, në fillim të vitit 2010, e kemi miratuar Planin e punës dhe kemi bërë përpjekje të realizojmë synimet përkatëse programore.

Furnizimi me libra shkollor, që e përmendi kryesuesi i këtij Komiteti, pavarësisht se është një numër simbolikë i completeve të librave meriton të përshëndetet një veprim i tillë, mirëpo duhet të shqyrtohen edhe mundësitë për sigurimin e një numri të bursave për nxënës të dalluar.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, pajtua me parafolësin se ky Komitet ka punuar mjaftë mirë dhe atë mbi bazën e Planit të punës derisa komunat tjera kanë punuar pa Plan të punës.

Në takimin e mbajtur kohë më parë në Zyrën rajonale të OSBE-së, u përmend se në një komunë të rajonit të Prishtinës, kryesues i Komitetit për Komunitete është pjesëtari i komunitetit shumicë e kam përmendur në takimin e cekur por po e theksoi sërish se kjo është në kundërshtim me dispozita ligjore meqë kryesues i Komitetit për Komunitete duhet të jetë nga komunitetet pakicë.

#### 4. Të ndryshme

**z. Mefail Mustafa**, OSBE – Zyra rajonale Ekipi për komunitete, theksoi se në korrik 2010 është mbajtur faza e parë e punëtorisë “Ngritje e kapaciteteve për anëtarët e Komitetit për Komunitete” ndërkaq faza e dytë, për komunat e rajonit të Prishtinës, e cila është mbajtur para disa ditëve e gjithë kjo për të ndikuar në punën më të suksesshme të Komiteteve për Komunitete.

Ne, Zyra rajonale, krahasuar me mandatet e mëhershme jemi të kënaqur me punën e tashme të Komiteteve për Komunitete, kuptohet disa kanë punuar më shumë e disa më pak.

Komiteti për Komunitete i Komunës së Podujevës ka dëshmuar kompaktësi dhe punë të mirëfilltë grupore dhe ju ka dhënë shembull komunave të tjera se si çështjet shqyrtohen dhe adresohen me konsensus dhe se mënyra e këtillë e punës krijon besueshmëri në mes të komuniteteve.

Ju lavdërova shumë por e gjithë kjo që thash është e vërtetë.

Çështja e mosrealizimit të disa vizitave në Komunat tjera të Kosovës për shkak të mungesës së mjeteve financiare, duhet të ju shërbejë që në të ardhmen

Planet e punës t'i bëni mbi bazën e mundësive të juaja, mirëpo duhet të jeni të bindur se OSBE gjithherë do të do të jetë përkrahëse dhe do të bëjë përpjekje të ndihmojë në realizimin e çështjeve të iniciuara nga Komuna.

Në vazhdim u zhvillua dialog lidhur me shqyrtimin e mundësive për realizimin e vizitave në komuna tjera të Republikës së Kosovës.

**Mbledhja përfundoi në orën 11,45.**

**Procesverbalin e mbajti**

**Faik Gashi**

**Nr. 01/251-06**

**Podujevë,**

**15 tetor 2010**

**Kyesuesi i Komitetit  
Shaban Ahmeti**